



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, më 28 maj 2010, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Teuta Hadri dhe Qamile Morina.

Munguan: Gjylnaze Sylaj, Nurishahe Hulaj dhe Vezira Emrush.

Delegacioni Zvicran: Ueli Leunenberger, anëtar i Parlamentit Zvicran dhe kryetar i Partisë së të Gjelbërve, Rita Schiavi – anëtare në udhëheqësinë e sindikatës UNIA, Jean Michel Varcher, specialist i sigurimeve në sindikatën SIT të Gjenevës, Shani Zekolli, sekretar në sindikatën SIT, Osman Osmani – sekretar i UNIA, në sektorin për migracion, Xhafer Xhaferi - nënkryetar i BSPK- së.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Takim me përfaqësues të BSPK- së dhe të delegacionit të sindikatave të Zvicrës (UNIA dhe SIT),**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim me përfaqësues të BSPK- së dhe të delegacionit të sindikatave të Zvicrës (UNIA dhe SIT)

Sadik Idriz – I përshëndeti mysafirët nga shteti Zviceran, dhe shprehi gatishmërinë e anëtarëve të Komisionit, që të bisedojnë lidhur me problemin që ekziston në mes të shtetit të Kosovës dhe shtetit të Zvicrës, lidhur me pensionet e qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë jetuar dhe punuar në shtetin Zviceran.

Rita Schiavi – Tha se delegacioni jonë është një delegacion i përbërë nga sindikata UNIA e SIT, dhe një deputet i Kuvendit të Zvicrës. Sindikata UNIA dhe SIT kemi organizuar nënshkrimin e këtij peticioni kundër vendimit të shtetit Zviceran, për ndaljen e pensioneve shtetasve Kosovarë, të cilët kanë punuar në Zvicër dhe e kanë lëshuar shtetin Zviceran. Këtë peticion e kemi dorëzuar në Qeverinë Federale Zvicerane dhe i kemi propozuar Qeverisë Zvicerane të negociojë një marrëveshje të re me shtetin e Kosovës.

Ne e kemi parë të domosdoshme që edhe në Kosovë ta njoftojmë Parlamentin, Qeverinë dhe popullatën e Kosovës për këtë problem. Nga kontaktet që i kemi pasur në Zvicër, por edhe nga kontaktet në Kosovë, e shohim të nevojshme që institucionet e Kosovës duhet të bëjnë presion në Qeverinë Zvicerane për negociimin e një marrëveshje tjetër.

Ueli Leunenberger- Jam i kënaqur që vij edhe një herë në Kosovë. Vendimi i njëanshëm i Qeverisë Zvicerane për shkëputjen e marrëveshjes bilaterale për pensionet, është një vendim i cili shkakton shumë pasoja për punëtorët e Kosovës, të cilët kanë punuar në Zvicër. Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës ende nuk janë të njoftuar mirë me pasojat e këtij vendimi. Shpresojmë që kontaktet tona në Kosovë të kontribuojnë që kjo çështje të jetë në rend të ditës dhe të debatohet më seriozisht në Kosovë.

Jean Michel Varcher- Tha se deri tani ka vlejtur marrëveshja që ka pasur Zvicra me shtetin e ish - Jugosllavisë. Pasi prej prillit kjo marrëveshje më nuk ekziston, kosovarët që dëshirojnë të kthehen nga Zvicra për të jetuar në Kosovë nuk mund ta gëzojnë më këtë pension, ndërsa ata që jetojnë në Zvicër gëzojnë një pension shumë të vogël.

Xhafer Xhaferi- Në takimin që patëm me ministrin e MPMS- së, ja dorëzuam peticionin e nënshkruar nga punëtorët kundër vendimit të Qeverisë Zvicerane. Nënshkrimin e këtij peticioni e kanë organizuar BSPK - ja dhe dy sindikatat Zvicerane UNIA dhe SIT. Qëllimi është që të kontribuojmë në zgjedhjen e kësaj çështje.

Sadik Idriz – Komisioni edhe më herët e ka ngritur këtë çështje dhe e kemi ftuar në një takim edhe ministrin. Ai ka premtuar se janë në bisedime me Qeverinë Zvicerane, por deri me tani nuk kemi rezultate konkrete. Nga ky takim do të jemi më të informuar dhe do të jemi më aktiv në zgjedhjen e kësaj çështje, sepse kjo është një shkelje e të drejtave të njeriut.

Rita Hajzeraj – Tha se i përshëndesim mysafirët për interesimin e tyre për këtë problem. Edhe ne, si Komision, jemi marrë aktivisht me këtë problem dhe e shohim të arsyeshme që të kontribuojmë më tepër në zgjidhjen e këtij problemi. Do shikojmë mundësinë edhe të një vizite në Parlamentin dhe Qeverinë Zvicerane për diskutimin dhe sensibilizimin e kësaj çështje. Jemi të befashuar me vendimin e shtetit Zviceran, sepse Zvicra është ndër shtetet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës, dhe duke pasur parasysh edhe situatën nëpër të cilën ka kaluar Kosova, ky vendim paraqet edhe një shkelje të të drejtave të njeriut. E kuptojmë që edhe angazhimi i Ministrisë gjegjëse të Kosovës, nuk ka qenë në nivel, por tani duhet shikuar mundësinë e daljes nga kjo gjendje.

Flora Brovina – Me ftesën e ish- ministres së Jashtme të Zvicrës, një delegacion i grave të Kosovës, në vitin 2005 ka vizituar Zvicrën. Që atëherë është shtruar nevoja e nënshkrimit të

një marrëveshje bashkëpunimi, por atëherë ishte një pengesë, sepse Kosova ende nuk ishte e pavarur. Tani Kosova është shtet i pavarur dhe kjo marrëveshje duhet të arrihet dhe të mos ekzistojnë këto pengesa. Kontribut më të madh duhet të japë ministria jonë e Punëve të Jashtme për arritjen e nënshkrimit të kësaj marrëveshje.

Rita Schiavi – Ne, si sindikatë interesohemi, sepse këta punëtorë janë anëtarë të sindikatës sonë. Me rëndësi është të kuptohet se ku është problemi. Qeveria Zvicerane ka dëshiruar që një mori marrëveshjesh bilaterale të rinegociohen me Kosovën, ndërsa Qeveria e Kosovës ka dashur që një pjesë të këtyre marrëveshjeve fare të mos e rinegocioj me Qeverinë Zvicerane, ndërsa marrëveshjen për sigurimet shoqërore ka qenë e interesuar ta negociojë më tutje. Qeveria Zvicerane ka dashur që të rinegociohen të gjitha marrëveshjet ose asnjë. Ky është një gabim nga të dyja qeveritë, si nga ajo Zvicerane, ashtu edhe ajo e Kosovës. Shkëputja e kësaj marrëveshje do të shkaktojë probleme për të dy shtetet. Qeveria Zvicerane do të ketë humbje, sepse këta njerëz që pensionohen do të jenë të detyruar të qëndrojnë në Zvicër dhe pensioni i tyre nuk do të ju mjaftojë për nevojat e tyre. Prandaj shteti zviceran do të obligohet të ju ndihmoj, ndërsa edhe shteti i Kosovës do të ketë humbje, sepse ata pensionistë, ato pensione do t'i sjellin në Kosovë dhe do t'i mbanin familjet e tyre, por edhe do të investonin këtu.

Ueli Leunenberger – Kjo çështje nuk është aktualizuar ende as në Parlamentin e Kosovë, as në Parlamentin Zviceran. Situata më e keqe është sa i përket shtesave fëmijërore.

Qamile Morina – Ne u shprehim mirënjohje për interesimin tuaj për këtë problem. Kërkesat e Qeverisë Zvicerane për marrëveshje me Qeverinë e Kosovës, a janë të ndryshme nga kërkesat me shtetet e tjera?

Cili mund të jetë kontributi jonë dhe i juaj në arritjen e një zgjidhje?

Ueli Leunenberger- Do të duhet të bëhet një propozim nga Kosova që Organizata Ndërkombëtare për Migracion, ose me ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare në Kosovë, të jetë si garant që pensionet që paguhen t'u paguhen njerëzve që jetojnë ende, pra të ekzistojë një organ garantues, pasi që në Kosovë nuk ka organ shtetëror sociale të sigurimeve nacionale, të cilët do të ishin partner. Është e kuptueshme që Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës dëshiron t'i rishikojë këto marrëveshje, të cilat ndoshta si pako nuk janë të gjitha të pranueshme, por me rëndësi është që të bisedohet dhe ndoshta të gjendet një zgjedhje e përkohshme deri në arritjen e një marrëveshje përfundimtare.

Teuta Hadri – E përshëndes iniciativën tuaj dhe shpreh gatishmërinë e bashkëpunimit në gjetjen e një zgjidhje. Zvicra si një shtet i pasur na ka befasuar me një vendim të tillë, e sidomos ndaj popullatës së varfër të Kosovës. Kjo mendoj se është edhe një shkelje e të drejtave të njeriut. Këtë vendim, a e ka marrë Zvicra edhe ndaj shteteve të tjera të ish-Jugosllavisë apo vetëm ndaj Kosovës?

Rita Schiavi- Me shtetet e tjera kjo marrëveshje është negociuar dhe me shumicën prej tyre është zgjidhur.

Xhafer Xhaferi - Kjo çështje duhet të ngrihet në nivel të Parlamentit dhe duhet të gjendet një zgjidhje sa më e shpejtë.

Rita Hajzeraj – Duhet të ndërmerren hapa konkret për gjetjen e një zgjidhje. Duhet ta shohim mundësinë që si Komision të bisedojmë me dy ministritë, MPMS- së dhe MPJ – në dhe me Qeverinë Zvicerane për gjetjen e një zgjidhje.

Ueli Leunenberger- Ju duhet të mundoheni të gjeni një zgjidhje të përkohshme. Duhet të kërkontë që si ndërmjetës të jenë Organizata Ndërkombëtare për Emigracion dhe të ju ndihmojnë në një zgjidhje të përkohshme, pastaj të arrihet marrëveshja përfundimtare.

Sadik Idriz – Ne kemi qenë të vetëdijshëm që problemi ekziston, por nuk kemi qenë të informuar mirë me krejt situatën, tani e kemi më të qartë. Ministri i MPMS - së na ka premtuar se kjo shumë shpejt do të zgjidhet, por tani po shihet që kjo situatë është shumë më serioze dhe kërkon zgjidhje.

Do të shikojmë që, bashkë me dy ministritë tona dhe me Organizatën Ndërkombëtare për Emigracion, të bisedojmë me Qeverinë Zvicerane, për të gjetur një zgjidhje, sepse pasojat janë shumë të mëdha për njerëzit e pafajshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz